



Begleitete Besuchstage Basel-Stadt. Ein Verein der GGG Basel.
Geschäftsstelle, c/o Pro Juventute beider Basel, Postfach, 4001 Basel
Telefon 061 261 22 28
info@begleitetebesuchstage-baselstadt.ch
www.begleitetebesuchstage-baselstadt.ch

FLETË INFORMATIVE PËR PRINDËR

Parimet udhëzuese të BBT

Fëmijët duan dhe kanë nevojë për të dy prindërit. Për zhvillimin e fëmijëve, është e rëndësishme për të mbajtur një marrëdhënie me të dy prindërit. Për më tepër, fëmija ka të drejtë ligjore për të kontaktuar me të dy prindërit. Për këtë arsye kontakti i rregullt me të atin dhe nënën është i rëndësishëm për fëmijën. Kjo vlenë edhe atëherë në qoftë se marrëdhënia mes prindërve është e vështirë apo takimi në mes të prindit dhe fëmijës ka nevojë për një mjedis të sigurt. Fëmija duhet të lejohet të jetojë marrëdhënien e tij me të dy prindërit, pavarësisht konflikteve që ekzistojnë në mes të prindërve. Konfliktet në mes prindërve nuk duhet të shkarkohen para fëmijës. Interesat e fëmijës duhet të jenë para interesave të prindërve. BBT siguron një kornizë të përkohshme për ushtrimin e të drejtave ligjore të vizitave, derisa prindërit brenda departamenteve përkatëse ta zhvillojnë një zgjidhje afatgjate.

Detyra dhe roli i ekipit shoqërues

- Ekipi shoqërues përcjellë dhe mbështet prindërit dhe fëmijët në organizimin e kontaktit gjatë kohës së vizitës.
- Ekipi shoqërues siguron rrjedhjen e ditëve të vizitave dhe te dorëzimeve në mënyrë të vazhdueshme të shoqëruara nga ekipi.
- Ekipi shoqërues do të sigurojë mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës.
- Ekipi shoqërues qëndron neutral përballë dy prindërve.
- Raportet me shkrim të ekipit shoqërues lëshohen rregullisht. Mbi të gjitha, vlenë të përmendet se ky ekip është subjekt i sekretit profesional.

Mbajtje-shënime gjatë rrjedhës së vizitave

- Prindi e organizon kohën, vizitën e tij me fëmijën në mënyrë individuale. Pastaj i gjithë grupi ulen në tavolinë dhe marrin shujtën e pasditës.
- Vizita nuk lejohet të ndërpritet gjatë kohës së organizuar.
- Gjatë vizitës egziston mundësia, të zhvillohen lojëra në kopshtin e mbyllur. Ju lutemi sigurohuni që fëmija juaj të jetë i veshur në mënyrë të përshtatshme duke ju përshtatur motit dhe eventualisht të ketë edhe rroba shtesë.
- Fëmija dhe prindi duhet të sjellin pantoflat me vete.
- Lodrat do të jenë në dispozicion gjatë kohës së vizitës. Prindi duhet të kujdeset, që të mos dëmtohen, apo të mos humben ato. Mbas përfundimit të vizitës, duhet patur parasysh që lodrat të vihen përsëri në vendin e duhur.

(ju lutemi lexonin shënimin në vazhdim në faqen e pasme)

- Çdo dëmtim i lodrave duhet të raportohet tek ekipi shoqërues.
- Sigurimi aksidental- dhe ai i përgjegjesisë janë qështje e pjesëmarrësve.
- Fëmijët janë të lejuar të sjellin lodrat e tyre dhe / ose materiale artizanale.
- Dhuratat, me perjashtim të kërkshëndellave dhe ditëlindjeve, lejohen të sillen, pasi të merren vesh me prindin tjetër. Mënyra e dhënjes së tyre duhet të bisedohet paraprakisht me ekipin shoqësues..
- Shpenzimet e përgjithshme si dhe pagesën e shujtës së pasdites, i merr përsipër prindi i cili e ka radhën e vizitës ditore me anë të faturës Fr. 20.-
- Nëse ndodhë mungesë paarsye, në vizitën e ardhshme duhet të paguhet edhe vizita, e cila nuk është mbajtur.
- Konsumimi i alkoholit dhe i drogës janë të ndaluara.
- Në të gjitha dhomat nuk lejohet pirja e duhanit. Opsionet e mundshme për pirjen e duhanit duhet të bisedohen me ekipin e shoqërimit.
- Përdorimi i telefonave celularë privat duhet të përdoren në minimum.
- Çlajmërimet tek qendra duhet të bëhen më së voni deri të premtën në ora 12.00, një ditë para terminit të vizitës:
T: 061 261 22 28
M: info@begleitetebesuchstage-baselstadt.ch
Në rast sëmundjeje mund të thirrni ndërmjet orës 12.30 dhe 13.00 direkt në shtëpinë ditore në Rebgasse: T: 061 683 94 00.